

Advanced Business Solutions-ABS

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "Advanced Business Solutions-ABS" shpk është regjistruar në regjistrin tregtar të shoqërive, më datë 08.05.2002, pranë Qendrës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatim taksat.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është: *Tregtim, import-eksport i paisjeve elektronike, informatike, mekanike të telekomunikacionit, të linjave dhe makinerive, të pjesëve të ndryshme të këmbimit. Ofrimi i shërbimeve të ndryshme telefonike të internetit. Ofrim i shërbimit të konsulencës së aktivitetit ekonomiko-financiar dhe hartimin e raporteve financiar. Ofrimin e shërbimit si komisioner Agjent Tregtar, aplikim imazhi grafik, video, audio, printim CV, DVD.*

Certifikimi tatimor NUIS: K21710002J

Kapitali themeltar: 236,040,354 lekë, i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 236,040,354 lekë.

Kuotat e pronësisë:

- Z. Gerond Meçe, zotërues 100% të kapitalit themeltar

Forma juridike e shoqërisë është: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Selia e shoqërisë nga muaji nëntor 2012 ndodhet në Rrugen Papa Gjon Pali II, H.11/1, Tiranë. Shoqëria në datë 31.12.2019 ka 46 punonjës ndërsa në datë 31.12.2018 39 punonjës. Numri mesatar I punonjësve gjatë 2019 është 44 punonjës.

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

a. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur, sipas parimit të materialiteti dhe vijimësisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi kontabilitetin Ligji nr. 9228 datë 29 prill 2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në "Standartet Kontabël Kombëtare" (SKK).

Lista e llogarive të përdorura për mbajtjen e regjistrimeve kontabël është ajo e shpallur nga Këshilli Kombëtar i Kontabiliteti.

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në bazë të konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Vlerat në pasqyrat financiare janë të shprehura në monedhën kombëtare LEKË, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

b. Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivitet afatgjata materiale janë regjistruar në llogaritë e shoqërisë me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar.

Advanced Business Solutions-ABS

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM të shoqërisë është metoda e vlerës së mbetur. Normat vjetore të amortizimit të aplikuara, janë si më poshtë:

Përshkrimi	Norma vjetore në %
Ndërtesa	5
Makineri Pajisje	20
Mjete Transporti	20
Mobilje Orendi	20
Pajisje Zyre Informatike	25

c. Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet

Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet janë paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar bazuar në shumat e faturave të dërguara klientëve ose të marra nga furnitorët.

d. Inventari

Në këtë zë janë përfshirë gjendjet e inventarit të "Mallrave për rishitje" tek të tretët. Inventarët maten fillimisht me kosto. Metoda e vlerësimit është metoda e kostos mesatare të ponderuar.

e. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën në LEKË dhe në monedhë të huaj si dhe paratë e mbajtura në bankat në Shqipëri.

f. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEKË (monedha funksionale e Shqipërisë) dhe regjistrohen me kursin e këmbimit të vendosur në datën e transaksionit. Mjetet monetare në monedhë të huaj konvertohen në LEKË me kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e pasqyrat e pozicionit financiarit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë si diferenca të realizuara nga kursi këmbimit.

Zëra të tjerë jo monetarë në monedhë të huaj konvertohen në LEKË duke përdorur kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën mbylljes së pasqyrave të pozicionit financiarit. Diferencat që rezultojnë nga kursi këmbimit paraqiten në pasqyrën e performancës në fund të vitit si diferenca të përealizuara nga kursi i këmbimit.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorur për vlerësimin e gjendjeve në valutë me datë 31/12/2019 janë: Kursi i këmbimit: **1 Euro = 121.77 Lekë/Euro** **1 USD = 108.64 Lekë/USD**

g. Njohje e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do t'i vijnë shoqërisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

h. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri.

i. Aksionet e kapitalit

Aksionet e thjeshta njihen si kapital. Aksioni (kuota e kapitalit) njihet me vlerën nominale.

j. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

3. SHËNIMET SHPJEGUESE

I. Aktivet Afatshkurtra

Shënim nr. 1: Mjetet Monetare

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me tepricat e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të mjeteve monetare në arken e shoqërisë. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në monedhën vendase, LEKË, duke përdorur kursin e këmbimit në datën 31/12/2019 publikuar nga Banka e Shqipërisë. Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i këtij instrumenti financiar është bërë në përputhje me paragrafët nr 11-21 të SKK-s së përmirësuar nr.3 "Instrumentat Financiarë".

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Paraja në Bankë	230,049,013	168,215,636
Paraja në arkë	26,322	376,467
Totali	230,075,335	168,592,103

Shënim nr. 2: Të drejta të arkëtueshme

2.1 Klientë: Në zërin "Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar të drejtat (llogaritë e arkëtueshme) që njësia ekonomike ka ndaj të tretëve si pasojë e aktivitetit të shfrytëzimit dhe të tjera, ku përmendim Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i tyre realizohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e SKK të përmirësuar Nr. 3 "Instrumentat Financiare", paragrafët nr. 11-21. Për vlerësimin e tyre është përdorur metoda e kostos së amortizuar.

Advanced Business Solutions-ABS

2.2 Të tjera:

Kjo pasqyron vlerën e TVSH-s që shoqëria ka paguar më tepër në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në datë 31/12/2019.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Nga aktiviteti i shfrytëzimit-Klientë	749,137,732	293,036,893
Të tjera-Tepricë TVSH në DPD	-	830,456
Totali	749,137,732	293,867,349

Shënim nr. 3: Inventarët

Zëri "Mallra" paraqitur në PF, në datën e raportimit 31.12.2019 janë zbatuar parimet e njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm në përputhje me SKK-t e përmirësuar nr.4 "Inventarët", paragrafët 8-33.

Kosto e inventarëve të përdorur gjatë periudhës dhe gjendja në datën e raportimit të PF, është matur-vlerësuar duke përdorur metodën e kostos mesatare të ponderuar.

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Mallra	60,177,536	107,499,617
Parapagime per inventar	33,616,800	1,075,784
Totali	93,794,336	108,575,401

II. Aktivet Afatgjata

Shënim nr. 4: Aktivet materiale

Aktivët afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2019 përbëhen nga:

Aktive të Qëndrueshme	Ndërtesa	Makineri Paisje	Mjete Transporti	Paisje Kompjuterike	Mobilje & Paisje Zyre	Totali
Gjendje 01.01.2019	98,872,909	740,410	9,655,823	3,689,915	1,893,838	114,852,895
Shtesa	59,375,400	242,883		336,701		59,954,984
Pakesime				13,167	85,836	99,003
Transferuar ne grupe te tjere						
Gjendje 31.12.2019	158,248,309	983,293	9,655,823	4,013,449	1,808,002	174,708,876
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2019	35,738,388	271,693	5,805,416	1,882,631	1,295,362	44,993,490
Shtesa	3,371,381	129,381	778,675	521,233	119,695	4,920,365
Pakesime				12,534	79,233	91,767
Transferuar ne grupe te tjere						
Gjendje 31.12.2019	39,109,769	401,074	6,584,091	2,391,330	1,335,824	49,822,088
Vlera neto 01.01.2019	63,134,521	468,717	3,850,407	1,807,284	598,476	69,859,405
Vlera neto 31.12.2019	119,138,540	582,219	3,071,732	1,622,119	472,178	124,886,788

Advanced Business Solutions-ABS

Aktivet afatgjata materiale janë pronë e shoqërisë, janë dokumentuar në mënyrë të rregullt dhe priten përfitime nga përdorimi i tyre në të ardhmen. Vlerat e mësipërme të AAM përputhen me inventarin fizik të tyre datë 31.12.2019.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve në pasqyrat e pozicionit financiar dhe në tabelën e mësipërme përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2019. Për trajtimin kontabël gjatë dhe në fund të periudhës raportuese, që nga momenti i njohjes për herë të parë të tyre në librat kontabël, duke vijuar me tej me matjen e vlerësimit të tyre në dalje dhe në datën e raportimit financiar, në përputhje me SKK nr 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" e përmirësuar, paragrafet 8-54. Pasqyrimi i tyre në PF është bërë me Vlerën Kontabël Neto në datën e raportimit. Në metodën e llogaritjes së amortizimit janë mbajtur parasysh dhe kërkesat e Ligjit nr 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 22, sipas metodës së përqindjes mbi vlerën e mbetur të aktivitetit.

Vlerësimi fillestar në momentin e njohjes si asetë është bërë me koston e blerjes dhe në datën e mbylljes së pasqyrave të pozicionit financiar paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar, si dhe pasqyrohen aktivet e blera gjatë vitit me fatura tatimore shitje dhe daljet e tyre dhe për aktivet e bëra dalje është llogaritur amortizimi deri në datën e fundit që këto aktive kanë qenë në përdorim të shoqërisë dhe aktivitetit ekonomik.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të renies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur për efekte fiskale.

Shënim nr. 5: Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Mirembajtje Sistemesh	2,601,369	4,707,496
Cerifikim ISO	239,901	659,416
Siguracion Kasko	48,413	85,691
Totali	2,889,682	5,452,602

Shënim nr. 6: Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara

Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

Advanced Business Solutions-ABS

	2019	2018
Të ardhura të llogaritura	9,420,488	3,697,500
Interesa aktive të llogaritura	13,717	-
Totali	9,434,205	3,697,500

I. Detyrimet Afatshkurtra

Të pagueshme ndaj furnitorëve: Të pagueshme ndaj furnitorëve janë paraqitur vlerat për tu paguar të tretëve për shitje mallrash/kryerje shërbimesh të kryera për shoqërinë.

Shënim nr. 7: Arkëtime në avancë

Përfaqëson vlerën që shoqëria ka arkëtuar në avancë, paradhenie nga klientët.

	2019	2018
Arkëtime në avancë	1,295,516	7,748,825
Totali	1,295,516	7,748,825

Detyrime për Sigurime Shoq.Shend: Pasqyron detyrimin që shoqëria ka për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore në baze të Listepagesës për muajin Dhjetor 2019. Këto detyrime janë paguar në muajin Janar 2020.

Shënim nr. 8: Të pagueshme për detyrime tatimore

Të pagueshme për detyrime tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Detyrime tatimore per TAP-in	10,811,726	2,972,327
Detyrime tatimore per Tatim Fitimin	25,379,028	14,368,378
Detyrime tatimore per Tvsh-ne	2,790,181	3,777,573
Detyrime tatimore per Tatim Burim	16,101	27,713
Totali	38,997,036	21,145,991

Detyrime tatimore për TAP-in: Pasqyron detyrimin që shoqëria ka për Tatimin mbi të Ardhurat Personale në baze të Listepagesës për muajin Dhjetor 2019. Këto detyrime janë paguar në muajin Janar 2020.

Detyrime tatimore për TVSH-në: Pasqyron detyrimin që shoqëria ka për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për muajin Dhjetor 2019. Këto detyrime janë paguar në muajin Janar 2020.

Shënim nr. 9: Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

Advanced Business Solutions-ABS

	2019	2018
Furnitore për fatura të pambërritura	34,946,149	95,827
Totali	34,946,149	95,827

Shënim nr. 10: Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Të ardhura dhe shpenzime të llogarit	85,027	
Interesa pasive të llogaritura	47,322	
Të ardhura të periudhave të ardhme	5,382,800	8,523,635
Totali	5,515,149	8,523,635

Shënim nr. 11: Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Dividentë për tu paguar	160,365,559	-
Borxh Ortakut	10,865,386	6,358,500
Totali	171,230,945	6,358,500

Shënim nr. 12: Kapitali aksionar

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

	Vlera e Kapitalit	Pjesëmarrja në %	Vlera e Kapitalit	Pjesëmarrja në %
	2019		2018	
Aksionarët				
Z. Gerond Meçe	236,040,354	100%	236,040,354	100%
Totali	236,040,354	100%	236,040,354	100%

Shënim nr. 13: Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Në këtë zë përfshihen të ardhurat e realizuara gjatë vitit ushtrimor 2019 nëpërmjet me shitjeve të mallrave, shërbime të faturuara me Faturë Tatimore Shitje me TVSH. Të ardhurat nga shitja e mallrave, materialeve apo shërbimeve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe

Advanced Business Solutions-ABS

përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marjen e përfitimeve, paragrafi 16-19 i SKK 8 i përmiresuar. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e raportimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri, referuar paragrafeve 20-43 të SKK 8 i përmiresuar. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marr parasysh shumën e kthimeve dhe uljeve të ofruara.

	2019	2018
Shitje mallrash	769,306,090	436,307,226
Të ardhura nga Shërbimet	383,804,076	377,200,644
Totali	1,153,110,166	813,507,870

Të ardhurat e shoqërisë subjekt për llogaritjen e tarifës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 (I ndryshuar), është në vlerën 17,774,024 lekë.

Shënim nr. 14: Kosto e mallit të shitur

Kosto e mallrave të shitur për vitin 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	2019	2018
Inventar ne celje	107,499,617	30,363,494
Shpenzimet per blerje mallra	479,521,016	444,932,435
Inventari ne fund te vitit	60,177,536	107,499,617
Kosto e mallit të shitur	526,843,097	367,796,312

Shënim nr. 15: Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzime të tjera shfrytëzimi më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

Advanced Business Solutions-ABS

	2019	2018
Energji uji,fax,telefon,internet	814,080	725,083
Shpenzime te qarkullimit te mallit e t	1,398,226	1,256,886
Qera	1,059,890	1,996,408
Materiale Pastrimi	98,890	80,415
Materiale Konsumi	682,186	1,050,195
Sherbime Kontabiliteti,Ekspertiza	360,000	410,000
Trajnime	4,530,397	1,230,112
Mirembajtje dhe riparime	457,976	536,778
Mbikeqyrje Tregu te Komunikimeve E	40,290	69,904
Sherbime nga transakione me pale te	122,589,298	97,530,286
Sherbim Noteri, Avokatie	1,048,278	1,122,039
Sherbim Doganor	570,788	588,358
Sigurime	1,517,636	1,306,078
Kancelari	750,404	181,407
Transferime udhetime, dieta, pritje p	7,519,131	4,453,415
Taksat Doganore e Bashkiake, te tjei	809,410	1,249,402
Shpenzime administrative,mirembajt	1,931,874	1,099,085
Gjoba e shpenzime te panjohura	11,815,756	5,886,386
Totali	157,994,510	120,772,237

Në zbatim të neni 16, pika 4 e ligjit "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar, vlera e paguar nga shoqëria për shërbim auditimi gjatë vitit 2019 është 360,000.00 Lekë pa TVSH.

Shënim nr. 16: Shpenzime financiare

Shpenzime financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

	2019	2018
Shpenzime për shërbimet bankare	470,335	311,255
Shpenzime per interesa	194,276	9,773
Të ardhura nga interesat	- 262,539	- 353,274
Humbje nga këmbimet valutore	3,117,989	8,550,003
Fitim nga kembimet valutore	- 4,217,605	- 2,597,133
Totali	- 697,544	5,920,622

Shënim nr. 17: Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka patur ngjarje pas datës së raportimit.